

---

## RIGJALLËRIMI I HUAZIMEVE TURKE NËPËRMJET MEDIAVE ELEKTRONIKE THE AFRESH ENLIVENING OF TURKISH BORROWINGS THROUGH ELECTRONIC MEDIA

SHPRESA HOXHA<sup>1</sup> & ARBËRESHA RAÇA – SHALA<sup>2</sup>

<sup>1</sup>Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, REPUBLIKA E KOSOVËS

<sup>2</sup>Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Prishtinë, REPUBLIKA E KOSOVËS

Email: shpprreessaa@hotmail.com

E-mail: arberesha.shala@gmail.com

AKTET VI, 5: 505 - 509, 2013

### PËRMBLEDHJE

Prania e huazimeve turke në gjuhën shqipe është mundësuar përmes fushave të ndryshme të jetës politike, shoqërore, ekonomike, artistike dhe fesë myslimane. Prania e tyre sot po rigjallërohet përmes filmave serikë të prodhimit të kinematografisë turke, që i ka pushtuar qendrat televizive jo vetëm në Kosovë, por në tërë Ballkanin. Punimi është përqendruar jo vetëm në përdorimin e tyre në shumë sfera jetësore të lartpërmendura, por edhe në përkthimin e tyre, që do të duhej të ishte në një shqipe standarde, pa lëshime e gabime gramatikore, drejtshkrimore të pakontrolluara, të cilat përcillen tek shikuesi me efekt negativ. Krejt kjo ndodh si rezultat i mosnjohjes së mjaftueshme të shqipes dhe i mosrespektimit të standardit të saj nga përkthyesit e papërgjegjshëm. Prandaj, duhet bërë bëhet thirrje për pastrimin e shqipes nga shfaqjet e panevojshme e të pakontrolluara.

**Fjalët çelës:** rigjallërimi, huazimet turke, standardi i gjuhës.

### SUMMARY

The presence of Turkish borrowings in Albanian is made possible through different fields, such as: political, social, economic, artistic, and Muslim religion. Their presence is enlivened through many TV serials of Turkish cinematography that have spread over all TV stations in Kosovo and throughout Balkans too. The paper is focused in their use in many spheres of life and in their translation, which was supposed to be in standard Albanian, without grammatical and orthographic mistakes or omissions etc. These mistakes go unchecked, and they are carried over to spectators by negative effect. This is as a result of the lack of knowledge of Albanian and of disrespecting the language standard from such irresponsible translators. It should be made an appeal to free Albanian from the presence of unnecessary, uncontrolled grammatical and orthographic mistakes.

**Key words:** enliven, Turkish borrowings, language standard.

### Hyrje

Prania e huazimeve turke në gjuhën shqipe është mundësuar në fusha të ndryshme politike, shoqërore, ekonomike, artistike, si dhe nga përkatësia fetare myslimane tek shqiptarët. “Futja e fjalëve turke në shqipen ka nisur qysh në shekullin XV dhe ka vijuar për më se pesë shekuj të pushtimit osman në Shqipëri deri më 28 nëntor 1912” (Shkurtaj 2006: 174).

Në ditët e sotme i dëgjojmë dhe i ndeshim dendur huazimet turke, kryesisht me rastin e shikimit të filmave serikë të prodhimit të kinematografisë turke, e cila ka pushtuar qendrat televizive, jo vetëm në Kosovë por edhe në tërë Ballkanin. Përkthimi, që duhej të ishte në një shqipe standarde, i programeve televizive, po lëshon edhe fjalë në turqishte, qoftë të ngulitura më herët, ose edhe ndonjë të re, si rrjedhim i mosnjohjes së gjuhës shqipe si duket nga

përkthyesi, ose edhe se ashtu i shembëllen më mirë atij, si atavizëm i së shkuarës. E njëjta gjë, në mënyrë krahasimtare, po ndodh edhe me seritë televizive në gjuhën spanjolle, të ardhura nga Amerika Latine, prej të cilave rinia me të madhe ka mësuar edhe spanjishten për komunikim, gjë që në këtë aspekt është e mirë dhe shumë shprehje të saj i përdorin edhe ndërmjet veti kur flasin shqip.

Duke u nisur nga konstatimi i profesor Eqrem Çabej: “Një nga gjuhët që kanë lënë gjurmët më të thella në gjuhët e Ballkanit është turqishtja, gjuha e perandorisë së Osmanëve” (Çabej 1987: 64), mund të thuhet se edhe sot e kësaj dite ndjehet ndikimi shumë i madh i turqishtes dhe gjurmët e thella dhe të pashlyeshme, pothuajse në të gjitha gjuhët ballkanike, por veçmas në gjuhën shqipe. Mbase, edhe për shkak se një përqindje e mirë e popullatës shqiptare ka përvetësuar me kohë besimin mysliman, por se kjo është e pranishme edhe te të krishterët, meqë shqiptarët kanë jetuar në harmoni pavarësisht nga përkatësia fetare.

Lidhur me përhapjen e huazimeve turke në gjuhët ballkanike profesor Çabej shprehet kështu: “Megjithatë, ka ndryshime në intensitetin e ndikimit të turqishtes në Ballkan. Sipas Selishçevit turqizmat janë më të shumta te Sllavët e te Shqiptarët, sesa ndër Rumunë e ndër Grekë” (Çabej 1987: 66). Mund të vë në dukje në këtë rast se ndikimi i turqishtes ka qenë dukshëm më i theksuar te popullsia myslimane në Bosnjë dhe te të gjitha trojet shqiptare në Ballkan. Këtë e dëshmojnë edhe shumë studiues të tjerë shqiptarë dhe të huaj. Më gjerësisht për këtë bëhet fjalë edhe në punimin e studiuesit Nebi Caka (Caka 2006: 29).

### **Shprehje të fushës shoqërore – politike, të zanateve e të jetës shtëpiake**

E pranishme sot lidhur me këtë çështje është gjallërimi i fjalëve dhe shprehjeve turqishte në fushën shoqërore – politike që janë përdorur gjatë periudhës së sundimit osman, meqë shumë prej tyre ekzistojnë në fjalorin e standardit të shqipes. Po vëmë në dukje disa prej tyre që kanë

nisur të përdoren jo rrallë në jetën e përditshme, pra te njëfarë gjallërimi i tyre:

(a) Përdorim i përgjithshëm: akraballëk, arallëk, mejtep, mejdan, bajraktar, muhabet, merak, konak, harem, saraj, asqer, dushman = armik, hafije = spiun, ispat = dëshmi, hallk = populli, njerëzit, hapsane = burg, dost = mik, myhyr = vulë, jesir = rob luftime, muhaxhir = i ardhur rishtas, shehër, mejdan, tepe = kodër, maja e kokës, pashallëk, tokmak, evlat, etj.

(b) Emra titujsh të cilët në të shumtën e rasteve përdoren në gjuhën turke dhe arabe pa u përkthyer fare në shqipet: sulltan, sulltaneshë, padishah, pasha, agë, bimbash (oficer, epror në ushtrinë e Perandorisë Osmane); esnaf, efendi, sheik, beg, spahi, haxhi (titull fetar që njerëzit e marrin kur shkojnë në Mekë e Medinë); kadi = gjykatës (zyrtar në kohën e sundimit osman, që kryente detyrën e gjykatësit dhe detyra të tjera civile e fetare) (FGjSSH 1981: 757); jenicer (ushtar këmbësor); bektashi, kallfë, dervish (besimtar, i sektit islam bektashi), sheh, reis (titull fetar mysliman), mulla (titull që i jepej atij që ndiqte mësimet në medrese ose një shërbyesi të thjeshtë në kultin mysliman); hoxhë me shkollë (FGjSSH 1981: 1180), pejgamber, mytesarif (kryetar i administratës së një sanxhaku), tyrbedar, zabit (oficer) (Ndreca 1986: 743), hanëm etj.

(c) Fjalë dhe shprehje nga fusha e ekonomisë - shumica prej tyre kanë përdorim të gjerë edhe sot dhe gjithsesi bëjnë pjesë edhe në gjuhën e unifikuar letrare shqipe, si: fajde (kamatë), harxh, haraç, bakall, çarshi, borxhli, çajhane, çirak, matrapaz, kulak (fshatar i pasur me tokë), karar (masë), kasap, myshteri (blerës), konsumator, marangoz (zdrukhtar), madem (xeherore), minierë (FGjSSH 1981: 1043), para (të holla), pazarllëk (bisedë që bëjnë blerësi dhe shitësi), qymyrxhi, qeleprixhi, ryshfet (mitë), shinik, rabush, usta, veresie, shegert, tatlixhi, terezi, tyxhar, xhamaxhi, zanat, yst (shtesë në të holla), yshyr (taksë), yshyri i tokës, xhelat, alet, bojaxhi, allishverish (shitblerje), zengjin, etj.

(ç) Emërtime për ushqime: gjellë, ëmbëlsira në kuzhinë dhe mënyrën e të ushqyerit dhe gatuarit të tyre: ashure, byrek, bakllava, bakllasarëm,

çorbë, jemek (gjellë), japrak, dollma, jallanxhi jemek, katmer (pite), kollpite, kurikoll (lloj i pites me djathë e ve), kavurme, pashaqyfte, revani, reçel, sarma, salep, sytljash, sytpite, kajmaçin (ëmbëlsirë me ve, sheqer dhe qumësht), sherbet, imam bajalldi, mantija, muhalebi (ëmbëlsirë e lehtë si qull prej qumështi), sheqeri dhe niseshteje ose orizi të bluar (FGjSSh 1981: 1179), turlitava, xhybek (lloj ëmbëlsire), sheqerpare, tatli, tullumba, gurabija, pilaf, zerde, bylmet, zejtin, gjyveç etj.

(d) Fjalë dhe shprehje (edhe të ritualit islam) të përgjithësuara në disa rrahe si të përsëritjes: selam (përsëritje), alejkym selam (dhe unë të përsëritjes), eivallah (të faleminderit, lamtumirë), meitep, abdes, ahiret (bota e amshueshme), gynah (mëkat), allah (Zot), sevap (vepër mëshire), bamirësi, hafëz, musaf (libër i shenjtë fetar mysliman), ramazan (muaji i agjërimit), hadit, iftar, syfyr, amin, amanet (porosi e fundit para se të vdes njeriu), estakfurullah (mos e dhëntë zoti), inshallah (dëshirë e zotit), afërim (të lumtë), synet, ma-shalla (mos të paftë syri i keq), mevlud, mulla, myezin, myfti, myderriz, myhib, mytesarif, ders (mësim), këshillë, imam (kryehoxhë), kuran, Kurban Bajram (festë fetare myslimane), namaz, qitap, rahmet, reçat, sheria (ligji, kodi civil i Perandorisë Osmane bazuar në fe), sabër, selamet, tyrbe, teqe, vakëf (bashkësi fetare myslimane), xhami, xhehenem, xhemat, xhenet, xhuma, xhahil, xharrah etj.

S'ka dyshim se në këtë rrafsh, feja islame ka luajtur rol të rëndësishëm tek shqiptarët që, duke ardhur nga lindja osmane, ka ndikuar në mjedisin tonë me shprehje e fjalë të ndryshme dhe pothuajse ka prekur të gjitha lëmitë.

### Zëvendësimi me fjalë shqipe

Të gjitha fjalët e shprehjet që kanë përkatësinë, madje shpesh edhe më të bukur, në gjuhën shqipe, apo që mund e duhet t'u hiqet prapshitesa turke, të hiqen nga përdorimi. Nuk bëhet fjalë për ngjyrosjen, karakterizimin e personazheve nëpër veprat letrare, theksimet ironike apo sarkastike në shkrimet gazetareske, të cilat kanë rëndësinë e tyre në larminë e stilit

dhe të parashtrimit bashkëkohor me kolorit të veçantë.

Në këtë rrah po theksoj prapshitesat *-xhi* (kryesisht për profesionet e ndryshme), *-li* (për përcaktimin e vendbanimit apo prejardhjes së personit), *-llëk* (apo llyk) (për theksimin e kuptimit, apo formimit të emrit nga mbiemri) në shembuj të tillë si: mullixhi, zhgunaxhi, sharrëxhi, zhurmaxhi, kallajxhi, qeleshexhi; osmanli, prishtinali, gjakovali, vendali; pisllek, njerzilllek, egërsilllek, pabesëlllek, zotnilllek.

Nga turqishtja po përdoren edhe huazime, të cilat përveç se i japin një ngjyrë ekspresive, karakterizuese, kanë konotacione, që në shqipet mund të zëvendësohen me më shumë se një fjalë, ku mund të shprehin kuptimin që ka fjala turke me gjithë ngjyrat e saj ose mund të zëvendësohet me fjalë shqipe.

Të folurit, por edhe krijimtaria letrare vazhdojnë t'i përdorin. Të folurit vijon të praktikojë nga rutina e vjetër e rrënjësuar nga sundimi osman ose edhe nga ndikimi i tanishëm i mediave që po i shqyrtojmë, kurse krijimtaria letrare po i përdor, megjithëse gjithnjë e më rrallë ashtu si kanë hyrë edhe fjalë e shprehje nga anglishtja, për efekt të karakterizimeve të personazheve të rrethanave apo për humor.

Megjithëse këto japin kolorit në parashtrimin gjuhësor të individit (me të folur, me të shkruar) është e mirë që brezave të rinj tu përgatitet dhe tu mësohet një gjuhë sa më të pastër shqipe.

Nuk po ndalemi ta analizojmë, arsyetojmë apo argumentojmë përfshirjen e tyre në fjalorin e gjuhës shqipe, ngase ato jo vetëm se janë natyralizuar në gjuhën tonë, por në disa raste edhe shprehin konotacione që në shqipe nuk ua gjejmë një fjalë krejtësisht përkatëse. Mbase në turqishte ato përdoren me atë kuptim që kanë, por përdorimi në gjuhën shqipe ka marrë tjetër konotacion të përafërt ose të ndryshëm: *bela*, *bylmet*, *kusur*, *kadife*, *hak*, *pare*, *çorbë*, *behar*, *zanat*, *top*, *bakllava*, *sarma*, *pilaf*, etj.

Po ashtu përdorim të dukshëm edhe përmes fjalëve ose shprehjeve në fjali si: Ata u ndanë *açik* si armiq. Për: Ata u ndanë në mënyrë të plotë (të prerë, të dukshme) si armiq; E mori vajzën me *ashikni*. Kjo thjesht zëvendësohet me fjalë shqipe:

E mori vajzën me *dashuri*; Veziri i dha *xhezanë* robrit:: Veziri i dha *gjobën* robrit, e ndëshkoi robin; Bëri  *pazarllëk* me fshatarin; *Mashalla*, sa shumë qenke rritur!; Nxori nga goja gjithfarë *maskarallëqesh*; Jemi bërë *kallaballëk* në shtëpinë tonë.

Për të gjitha fjalët të cilat mund të kenë edhe aso konotacione që të mos u përshtatet siç duhet përkthimi në gjuhën shqipe duhet bërë përpjekje të parashtrihen shqip. P.sh. fjala *mashalla* nuk ka një fjalë përkatëse në shqip, por mund të perifrazohet me shprehjen *mos të paftë syri i keq*, apo me urimin *të lumtë* që përafërsisht shprehin kuptimin e fjalës turke. Kjo vlen për të gjitha rastet e tilla.

“Strategjia kombëtare gjuhësore duhet të jetë në kompetencë të institucioneve më të larta, duke përfshirë këtu akademitë, institucionet e këshillat kombëtare gjuhësore, të cilat duhet të shqyrtojnë dhe të vlerësojnë politikën tonë gjuhësore me qëllim që të krijohen rrethana sa më të përshtatshme për përdorimin dhe funksionimin sa më të mirë të shqipes si gjuhë standarde në të gjithë hapësirën komunikuese të saj dhe në krijimin e mekanizmave për analizën e perspektivave të këtij përdorimi” (Islamaj 2008: 47).

Një pjesë e huazimeve të fushës ekonomike, politike, administrative, kulturore janë zëvendësuar me fjalë shqipe apo edhe me neologjizma të natyrës së gjuhës shqipe ose me fjalë e shprehje të marra nga gjuhët evropiane, proces i cili ka filluar që herët, falë intelektualëve të pakët shqiptarë të hershëm dhe ka vazhduar dhe vazhdon edhe sot, natyrisht në mënyrë të minimizuar pasi është ndërtuar gjuha e fushave përkatëse. P.sh.: *hesap* (llogari, bilanc); *ispat* (dëshmitar), *myhyr* (vulë), *vatan* (atdhe).

Disa prej këtyre fjalëve përdoren edhe sot në të folur, megjithëse jo fort shpesh.

“Burimi kryesor i pasurimit të shqipes me fjalët që i duhen është **formimi i fjalëve të reja me burimin e vetë gjuhës** dhe sipas modeleve prodhimtare të sistemit fjalëformues të saj ose nëpërmjet shqipërimit të pjesëve përbërëse të fjalëve të huaja. Sot numri i fjalëve të reja të formuara me rrugët e mësipërme është i madh në të gjitha sferat e veprimtarisë së shqiptarëve.

Të tilla janë p.sh.: *domosdoshmëri, gatishmëri, qëndrueshmëri, mbingarkoj, mbishtresë, mbivlerë, nënçmoj, nëndetëse, nënujor, përvetësim, përparësi, i përafërt, përvijoj, përuroj, ideor, parimor, burimor etj.*” (Shkurtaç 2006: 165). Në këtë drejtim mund të kontribuojmë edhe nëpërmes hartimit dhe të përpilimit të fjalorëve të ndryshëm e në veçanti fjalorëve të gjuhës shqipe, duke u përpjekur që të ruajmë fjalët burimore shqipe dhe në krijimin e fjalëve dhe frazeologjizmave të reja, por sërish të mbështetura nga thesari i gjuhës dhe nga goja e popullit.

“Në shumë vende të botës përparimi i shoqërisë shkon dora-dorës me njohjen e gjuhës amtare. Qysh para disa shekujsh në parlamentin francez nuk kanë mundur të ulen deputetë pa njohjen e shkëlqyeshme të frëngjishtes – e nuk mund të ulen as sot ngaqë frëngjishtja konsiderohet simbol i bashkimit kombëtar” (Murati 2005: 26). Lidhur me këtë tek ne, kjo çështje është e papërfillshme dhe e vështirë për tu realizuar jo vetëm në Parlament, por edhe në institucione të tjera politike, arsimore, ekonomike.

### Përfundim

Është detyrë e çdo qytetari sidomos e intelektualëve që të luftojnë në çdo mjedis, në çdo çast kundër kësaj dukurie e në mënyrë të veçantë do të thosha të prerë kundër përdorimit të disa shprehjeve religjioze, qofshin këto turke apo arabe, si: Allahu ju dhashtë sabër! Rahmet pastë, I qoftë rahmet, Merhaba të cilat kanë shprehje të bukura shqipe si: Zoti ju dhëntë durim, Paçi durim, Ndjesë pastë, Mirë se rini, Përshtëndetje.

Të bëhet thirrje për pastrimin e gjuhës shqipe nga këto dukuri të panevojshme dhe të bëhen përpjekje për zëvendësimin e fjalëve dhe shprehjeve turke, por edhe të atyre nga gjuhët e tjera, me fjalë shqipe, siç bëjnë shumë popuj të tjerë në krijimin e fjalëve dhe shprehjeve të mundshme në gjuhën amtare. Na është e njohur se pastrimi absolut i gjuhës është i pamundur dhe larg pikësynimit tonë, por duhet punuar në drejtim të pasurimit të gjuhës shqipe me përpilimin e fjalëve të reja përmes pasurisë leksikografike dhe të kontribuojmë edhe për të ruajtur identitetin tonë ko-

mbëtar me përpjekje të vazhdueshme për kultivimin e shqipes dhe përkushtimit të gjuhëtarëve, i cili duhet të jetë në nivelin më të lartë të duhur.

Përpjekjet për përmirësimin e imazhit të standardit të gjuhës shqipe duhet të bëhen vijimisht. Mbetet detyrë dhe përgjegjësi e institucioneve edukativo – arsimore që t'i motivojnë sidomos moshat e reja për mësimin dhe të folurit e drejtë të shqipes, duke i përfshirë të gjitha llojet e mediave, të cilat luajnë rol tejet të rëndësishëm për sa i përket aspektit edukativo – arsimor e në veçanti edhe atij gjuhësor.

### **Bibliografia**

- CAKA, Nebi (2006), Huazimet leksikore dhe qëndrimi ndaj tyre: *KOHA për kulturë*, Nr. 324: 29, *KOHA Ditore*, Nr. 3339. Prishtinë, 30. XI. 2006; <http://www.peshkupauje.com> (13. X 2006).
- ÇABEJ, Eqrem (1987), *Studime gjuhësore III*, Rilindja, Prishtinë.
- ISLAMAJ, Shefkije (2008), *Gjuha dhe identiteti*, Botimet TOENA, Tiranë.
- KOSTALLARI, Androkli (red.)(1981), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Rilindja, Prishtinë.
- MURATI, Qemal (2005), *Trajtesa albanologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
- NDRECA, Mikel (1986), *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Rilindja, Prishtinë.
- SHKURTAJ, Gjovalin (2006), *Kultura e gjuhës*, ShBLU, Tiranë..